



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KOMISIONERI PËR MBROJTJEN
NGA DISKRIMINIMI

FONDACIONI SHQIPTAR PËR TË
DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI
TË KUFIZUARA

Nr. 63 Prot, datë 21.02.2012

Nr. 005 Prot, datë 21.02.2012

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Dhe

FONDACIONIT SHQIPTAR PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI
TË KUFIZUAR

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI, si institucion shtetëror i cili funksionon në bazë të ligjit Nr. 10 221, datë 14.02.2010 “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”, që këtu e më poshtë do të referohet si Komisioneri (*Pala*);

FONDACIONI SHQIPTAR PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA, si person juridik, regjistruar me Vendimin Nr. 176, datë 18.10.1996 të Gjykatës të Shkallës të Parë, Tiranë, që këtu e më poshtë do të referohet si FSHDPAK (*Pala*);

Duke qënë se Komisioneri është institucioni që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin;

Duke qënë se FSHDPAK zhvillon veprimtarinë e tij në sferën e aftësisë të kufizuar duke ofruar, ndër të tjera, Konsulencë Ligjore dhe Avokati falas për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe përmirësimit e cilësisë së jetës së tyre;

Me synimin e përbashkët për respektimin dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;

Me objektiv garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, sigurimin e të drejtës së çdo personi për, brarazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat e për të gëzuar liritë, për mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, për personat me aftësi të kufizuara;

Me angazhimin për të asistuar njeri-tjetrin mbi parimin e reciprocitetit, dhe me bindjen se bashkëveprimi është në ndihmën dhe interesin e qytetarëve;

Palët,

Bien dakort si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i Marrëveshjes

1.1 Kjo marrëveshje ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe modaliteteve brenda të cilave Palët do të zhvillojnë, marrëdhëniet ndërmjet tyre, për marrjen e masave për mbrojtjen nga diskriminimi për personat me aftësi të kufizuara.

Neni 2

Angazhimet e paleve dhe format e bashkëpunimit

2.1 Palët do të bashkëpunojnë për ofrimin e një shërbimi të plotë ligjor për të gjithë personat me aftësi të kufizuara apo familjarët e tyre, që paraqesin ankesa pranë tyre, i cili do të përfshijë ndihmën për zgjidhjen e problemeve në organet e administratës shtetërore dhe shërbimin e plotë ligjor për zgjidhjen e problemeve jashtëgjqësisht.

2.2 Komisioneri angazhohet të bashkëpunojë me FSHDPAK për rastet e personave me aftësi të kufizuara të cilët kanë nevojë për asistencën e Komisionerit gjatë proceseve

